

HICKA - LAW - LEGACY

Av. Envi Hicka
envi.hicka@hickalawlegacy.com
NIPT: L41310006J
nr. licence 1776,
Rr. e Kavajës
Garden Building
Kulla 1, Hyrja A
Kati 2, Ap. 4
Tiranë, Shqipëri (Albania)

SHTEG

Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe
Korrupsionit në Shqipëri

Rr. Shefqet Musaraj 14, H1, Ap.19,
1001, Tiranë, Shqipëri

Në vemendje të znj. Desada SADIKU
desada.sadiku@shteg.org

Lënda: Në lidhje me pyetjet e drejtuara z. Gentian Parruca, ne raport
me ndertimin e miratuar rrugën "Emin Duraku" dhe shkrimin
bere prej jush ne daten 07.05.2025.

Tiranë, më 12 Maj 2025

Të nderuar Zotërinj të SHTEG
E Nderuar znj. SADIKU,

1. Ju shkruaj në cilësinë e avokatit të shoqërisë A&E Development, sipas autorizimit të administratorit të shoqërisë, z. Fatjon ALLIU. Gjithashtu ju shkruaj edhe në emrin e z. Gentian Parruca të cilit ju i keni shkruar duke i drejtuar disa pyetje ne daten 02.05.2025.
2. Duhet t'ju them qe ne fillim se nga ana e shoqerise dhe z. Parruca ju konsideroheni, si nje subjekt qe keni cenuar krey pa arsye reputacionin dhe interesat e biznesit te shoqerise. Duke nisur qe nga pyetjet qe keni përcjellë e më pas deri tek shkrimi qe keni publikuar, ju keni



përhapur qëndrime subjektive, aluzione dhe opinione në lidhje me çështjen e ndërtimit në rrugën Emin Duraku, duke patur për qëllim thjesht të nxirni në një dritë paligjshmërie procesin e ndërtimit dhe figurën personale të njërit prej ortakëve të shoqërisë A&E Development shpk. Jeni etapa e radhës e një fushate të turpshme për cënimin e interesave të shoqërisë dhe të z. Parruca. Ju lutem t'i përcillni edhe porositësve tuaj, se qoftë ju apo të tjerë instrumenta mediatikë, duke nisur nga kjo letër do të përballeni me përgjegjësitë tuaja ligjore.

3. Me këtë rast dua t'ju përcjell faktin se pavarësisht një emri të sajuar sipas traditës më të shëmtuar të pararendësve tuaj, më të famshëm, që gjithashtu abuzojnë me rolin e gazetarit në një shoqëri demokratike, ju nuk jeni identifikuar se çfarë përfaqëson Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri, një organizatë jo fitimprurëse, shoqëri tregtare, apo ndonjë formë tjetër të personave juridikë. Fakti që nuk identifikoni formën juaj të organizimit dhe funksionimit, është simptomë e faktit që keni qëllimin të evitoni përgjegjësitë ligjore, për shkrimet tuaja. Me këtë rast ju kërkoj të identifikoni personalitetin tuaj juridik.
4. Për të njëjtën arsye, për t'ju dhënë mundësinë të rehabilitoni disi pozitën tuaj dhe të korrektoni standardin krej të papërshtashëm që keni treguar deri më tani, duhet t'ju bëj të ditur se nëse dikujt i dërgoni pyetje për të marrë qëndrimin e tij, nuk mund të kërkonti përgjigje brenda ditës sic keni bërë ju. Përgjigjet për këto pyetje po jua përcjell më poshtë duke ju kujtuar se standardi i gazetarisë kërkon që ju t'i publikoni edhe këto përgjigje, pavarësisht se kanë mbërritur pasi keni publikuar shkrimin.
5. A jeni aksioner te kompania "Hotel Domus" sh.p.k.,?

Z. Gentian Parruca nuk është aksioner te shoqëria "Hotel Domus" shpk. Në cdo rast shoqëria Hotel Domus shpk nuk ka aksionerë, sepse duke qenë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ka ortakë.

6. Cila është marrëdhënia juaj me Arjan Ormenaj, Erjon Ramën, Manjola Hysenajn, Klajdi Merkajn dhe Bledar Pajën?

z. Parruca nuk ka asnjë mardhënie, as ka patur në të shkuarën asnjë marrëdhënie me këta individë, përvec znj. Manjola Hysenaj, me të cilën është bashkëpronar në një pasuri të paluejtshme, të blerë dhe të regjistruar në mënyrë publike, ku secili prej bashkëpronarëve ka paguar cmimin në proporcion me pjesën e tij në bashkëpronësi.

7. Cila kanë qenë kundërshtimet e paraqitura së bashku me të paditurit të lartpërmendur ndaj vendimit nr. 43, datë 19.09.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për sekuestrimin e pronës së "Hotel Domus"?

Z. Parruca nuk ka paraqitur me asnjë prej atyre që ju i quani "të paditur" asnjë kundërshtim në lidhje me sekuestrimin e pronës Hotel Domus.

8. A jeni në dijeni se jeni të përfshirë në një biznes ku dyshohet të kenë gjurmë grupe të organizuara kriminale?

z. Parruca nuk është përfshirë në asnjë biznes ku dyshohet të kenë gjurmë grupe të organizuara kriminale. Cilit biznes i referoni ju dhe cilit grup të organizuar kriminal i referoheni? Nuk është e lejueshme nga asnjë standard i komunikimit që të pohoni se dikush është i përfshirë në biznese ku dyshohet se kanë gjurmë grupe të organizuara kriminale. Cilave të dhëna i referoheni ju në lidhje me përfshirjen e z. Parruca në biznese ku kanë gjurmë grupe kriminale? Cfarë duhet kuptuar me shprehjen "kanë gjurmë"?

9. A keni komunikuar me znj. Margariti si trashëgimtarë të pronës ku po zhvillohet objekti i projektuar nga ju?

Znj. Elva Margariti nuk është trashëgimtare e pronës. Termi trashëgimtare e pronës nuk ekziston në të drejtën civile. Trashëgimtarët janë të relacionuar me trashëgimlënësit (personat që vdesin) por jo me prona të vecanta. Ju e përdorni termin "trashëgimtare e pronës" vetëm për shkak se doni të lidhni zhvillimin me figurën e znj. Elva Margariti, për të ngritur dyshime në lidhje me ligjshmërinë e këtij zhvillimi. Në fakt pronërit e pronës janë individë të tjerë.

10. Dyshohet se jeni mik i afërt me Elvis Roshin, ish-kryebashkiakun e Kavajës, nën hetim nga SPAK për "shpërdorim të detyrës". Cila është marrëdhënia juaj me të?

Kush e dyshon miqësinë e afërt të z. Elvis Roshi? Nga cilat rrethana burojnë këto dyshime? Z. Parruca nuk ka asnjë raport njerëzor me z. Elvis Roshin.

11. Duke qenë se znj. Margariti ka qenë në një pozicion zyrtar politik, si ish-këshilltare për Territorin pranë Kryeministrit të Shqipërisë dhe si ish-ministre e Kulturës, a ndjeni si përgjegjësi që po mbështesni moszbatimin e vendimit të vitit 1998 të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe vendimin e vitit 2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të cilët për të njëjtat arsye kanë rrëzuar vendimet e ndërtimit të objekteve?

Nuk arrij të kuptoj çfarë përgjegjësie duhet të ketë z. Parruca në raport me detyrat publike të Znj. Elva Margariti. Z. Parruca nuk ka mbështetur asnjëherë moszbatimin e ndonjë vendimi gjyqësor. Referimet që bëni ndaj disa vendimeve gjyqësore, nuk arrijnë të na japin informacion për lidhjen juridike të tyre me z. Gentian Parruca.

12. A e keni diskutuar me banorët këtë vendim, për të marrë mendimin e tyre?

Nuk arrijmë të kuptojmë cilit vendim i referoheni dhe çfarë diskutimesh, apo me cilët individë që ju i quani "banorë"?

13. Në momentin kur kanë nisur procedurat, a keni qenë të shqetësuar për cënimin e të drejtës së banimit dhe të sigurisë të banorëve dhe të shkollës 9-vjeçare "Emin Duraku"?

Nuk është e mundur të kuptojmë se cilave "procedura" i referoheni. Z. Parruca nuk është në dijeni të ndonjë rrethane që vë në rrezik sigurinë e ndonjë individi, apo të ndonjë ndërtese.

14. Pasi ju kam dhënë përgjigje për të gjitha pyejtet, të cilat ju kërkoj t'i botoni për efekt transparence, dua t'ju rendis edhe pjesët më të shëmtuara dhe të pavërteta të shkrimit tuaj që përbëjnë cënim të reputacionit të shoqërisë A&E Development dhe të z. Gentian Parruca.

15. Ju shkruani: "Projekti është hartuar nga studio "Focus Architecture" dhe do të realizohet nga kompania "A & E Development" në pronësi të Gentian Parrucës, ky i fundit nën hetim nga GJKKO për përfshirje në një grup të strukturuar kriminal."

16. Ky është një shtrëmbërim dhe një ofendim i hapur ndaj shoqërisë dhe z. Parruca. E para shoqëria ka dy ortakë. E dyta, GJKKO, duke qenë Gjykatë nuk kryen hetime. E treta, z. Gentian Parruca nuk është nën hetim për asnjë përfshirje në asnjë grup të strukturuar kriminal. Të tri këto saktësime në ju kërkojmë që t'i publikoni, pa ndryshuar fjalët tona. Po ashtu ju kërkojmë që të publikoni të dhënat, dokumentat, faktet apo rrethanat që ju ka cuar të dilni në konkluzionin se z. Parruca është nën hetim për përfshirje në ndonjë grup të strukturuar kriminal dhe në cilin grup. Nëse ju nuk i publikoni këto, ne do të kuptojmë se ju nuk keni fakte të tilla, por i krijoni ato për të cënuar reputacionin e z. Parruca dhe të biznesit ku ai është i përfshirë. Në këtë rast do të përballeni me procedura ligjore.

17. Ju shkruani: "Dokumentet e siguruara nga "shteg.org" tregojnë se Gentian Parruca, ndërtuesi i kullës, ndodhet nën hetim nga SPAK. Prokuroria ka rënditur emrin e tij në listën e gjatë të personave të lidhur me organizatën kriminale të vëllezërve Çopja. Sipas dosjeve hetimore, grupi akuzohet për vrasje me pagesë, trafik droge dhe pastrim parash përmes ndërtimeve të mëdha në Tiranë.

“Shteg.org”, i dërgoi një kërkesë për koment biznesmenit Gentian Parrucës në lidhje me akuzën si i dyshuar i përfshirë në këtë grup kriminal dhe marrëdhënies së tij me ish-ministren e Kulturës, Elva Margariti. Po ashtu, ai u pyet dhe në lidhje me miqësinë e afërt me Elvis Roshin, ish-kryebashkiakun e Kavajës, edhe ai nën hetim nga Prokuroria e Posaçme. Deri në momentin e publikimit të këtij shkrimi, redaksia nuk mori një përgjigje nga ana e tij.”

18. Z. Parruca nuk është nën hetim nga SPAK. Nuk ka asnjë dokument që tregon ndonjë lidhje të z. Parruca me organizatën e vëllezerve Copja. Ju lutem të publikoni jo vetëm këtë qëndrim të z. Parruca, por edhe kërkesën për të publikuar dokumentat që sipas jush tregojnë faktin që z. Parruca është nën hetim, që është i lidhur me organizatën e vëllezrve Copja. Po ashtu ju kërkohet të publikoni të dhënat që tregojnë miqësinë e afërt të z. Parruca me z. Elvis Roshin. Nëse ju nuk i publikoni këto dokumenta, do të përballeni me përgjegjësitë ligjore që ka kushtuar që publikon rrethana të pavërteta.
19. Nëse në një kohë të arsyeshme ju nuk do të publikoni të gjitha përgjigjet tona, dokumentat të cilave u jeni referuar, dhe korrektimet e fakteve sipas rrethanave reale, duke sqaruar pasaktësitë rreth z. Parruca dhe shoqërisë ku është ortak, do të duhet që të nisim procedurat ligjore që do të korigjojnë këtë gjendje të dhënash të shtrembëra. Po ashtu ju paralajmëroj që të mos përsërisni në të ardhmen sjellje të ngjashme ku synoni t'i shërbeni interesave të personave, që kanë zgjedhur në vend të rrugëve juridike, fushatat e denigrimit të individëve.

Shpresoj t'i vini gisht kokës,

Av. Envi HICKA